
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

[Data 15.12.2025]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) X ose

EMRI: "ALB-MATRIX GROUP" SHPK

NIPTI: L91616027G

ADRESA: TIRANE RRUGA "ISA BOLETINI" SHK.9 /1/A3 / PRIVAT

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar -kontratë

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-66994-10-28-2025

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Blerje pajisje GPS" për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR.

Fondi limit: 5,567,000 (pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 21/11/2025

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit [Data 25 Nëntor 2025] [Numri 75]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1.OE "XPERT SYSTEMS " SH.P.K **L51511023L**

Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-t*

Vlera: 3,885,500 (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2.OE "ALB-MATRIX GROUP " SH.P.K **L91616027G**

Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Vlera: 4,176,010 (katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dhjetë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OE "LAND & CO" SH.P.K. **J87730202A**

Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Vlera: 4,180,000 (katër milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4.OE “GeoTech” sh.p.k

K91923003D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera : 4,850,700 (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. OE “A-T-D” ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” SHPK

L21811033B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-i

Vlera: 5,567,000 (pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“A-T-D” ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” SHPK me NIPT L21811033B**, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit per arsyet si me poshte:

- Operatori ekonomik **“A-T-D” ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” SHPK me NIPT L21811033B**, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit pasi pervec formularit te ofertes, nuk ka paraqitur asnje dokument tjeter per permbushjen e kriterave te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2.Operatori ekonomik **“XPERT SYSTEMS” Sh.p.k me NIPT L51511023L** me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

Operatori ekonomik **“XPERT SYSTEMS” Sh.p.k, me NIPT L51511023L**, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit, pikën 2, në të cilën kërkohet:

“Për artikullin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, në të cilin të përcaktohen të dhënat e kontaktit të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet këtij distributori dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: numër telefoni, adresë e-mail dhe website, për qëllime verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.”

Gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga operatori ekonomik **“XPERT SYSTEMS” Sh.p.k**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka konstatuar se ndër dokumentet e ngarkuara ndodhet një file në format PDF, me emërtimin *“autorizim_prodhuesi.pdf”* dhe madhësi 2.22 MB.

Megjithatë, gjatë procesit të vlerësimit, KVO nuk ka mundur të aksesojë dhe të verifikojë përmbajtjen e këtij dokumenti, pasi file-i në fjalë nuk hapet. Si rrjedhojë, është e pamundur të verifikohet përmbajtja dhe vlefshmëria e tij, në mënyrë që Komisioni të mund të konstatojë përmbushjen e kërkesës përkatëse të kualifikimit.

- Operatori ekonomik **“XPERT SYSTEMS” Sh.p.k, me NIPT L51511023L**, nuk përmbush pikën 3 të kriterit të veçantë të kualifikimit, në të cilën kërkohet: *“Për artikullin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi, ku të evidentohen pajisjet e ofruara dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.”*

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe i dokumentit origjinal në gjuhën angleze, në formë fotokopie, pa u njësuar me origjinalin.

Kjo është në kundërshtim me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: *“Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.”*

Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: *“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.”*Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (origjinale ose kopje e

noterizuar), dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë për vlerësim të mëtejshëm nga KVO.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3.Operatori ekonomik “LAND & CO” Sh.p.k, me NIPT J87730202A, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

- Operatori ekonomik **“LAND & CO” Sh.p.k, me NIPT J87730202A**, nuk vërteton përmbushjen e pikës 5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën kërkohet: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatë CE ose ekuivalente e saj, si dhe të deklarojë se në momentin e dorëzimit, pajisja do të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC/ Certifikatë CE ose ekuivalente e saj, që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin e përcaktuar në specifikimet teknike”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se operatori ekonomik ka deklaruar vetëm se pajisja disponon Certifikatë Konformiteti, por nuk ka deklaruar se ajo do të shoqërohet me këtë dokument në momentin e dorëzimit, siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

Në këto kushte, operatori ekonomik nuk përmbush pikën 5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe për këtë arsye skualifikohet.

- Operatori ekonomik **“LAND & CO” Sh.p.k, me NIPT J87730202A**, nuk vërteton përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Shtojcën 4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit “Sigurimi i Ofertës”, sipas pikës 3.2, ku kërkohet që periudha e vlefshmërisë së ofertës të jetë minimalisht 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.

Nga verifikimi i sigurimit të ofertës të paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), rezulton se operatori ekonomik ka deklaruar periudhë vlefshmërie prej vetëm 30 (tridhjetë) ditësh nga data e skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, çka është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në këto kushte, operatori ekonomik **“LAND & CO” Sh.p.k** nuk përmbush kërkesën për vlefshmërinë minimale të sigurimit të ofertës dhe për këtë arsye skualifikohet nga procedura e prokurimit.

- Operatori ekonomik **“LAND & CO” Sh.p.k, me NIPT J87730202A**, Nuk vërteton se përmbush piken 2 ne kërkesat për kualifikim ku kerkohet: *“Për artikullin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë: autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar.*

Në rast se, do të paraqitet autorizimi nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të

prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe i dokumentit origjinal i pa shoqeruar me Vërtetimi i përkthimit nga Noteri në kundërshtim me nenin 135 “Vërtetimi i përkthimeve” të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku citohet se: *“Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.”.*

Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (përkthim i shoqëruar me vërtetim përkthimi noterial) dhe për këtë arsye, operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit.

- Operatori ekonomik **“LAND & CO” Sh.p.k**, me NIPT **J87730202A**, nuk vërteton se përmbush piken 3 në kërkesat për kualifikim ku kërkohej: *“Për artikullin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi, ku të evidentohen pajisjet e ofruara dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.”*

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe, në formë fotokopie me ngjyra, pa u njësuar me origjinalin dhe i pa shoqeruar me vulën e përkthyesit zyrtar nga Anglishtja në Shqipe..

Kjo është në kundërshtim me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: *“Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.”*

Gjithashtu, dokumenti është i pa shoqeruar me Vërtetimi i përkthimit nga Noteri në kundërshtim me nenin 135 “Vërtetimi i përkthimeve” të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku citohet se: *“Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga*

persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.”.

Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.”

Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (origjinale ose kopje e noterizuar), dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë për vlerësim të mëtejshëm nga KVO.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4.Operatori ekonomik “GeoTech” shpk me NIPT K91923003D, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

- Operatori ekonomik **“GeoTech”shpk me NIPT K91923003D,** me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim piken 7, ne te cilin percaktohet: *“Operatori ekonomik fitues duhet te disponojë të paktën 1 (një) specialist të pajisur me certifikate trajnimi të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar ose autoritete / ente të tjera, të autorizuar për lëshimin e certifikatave të formimit profesional/ose ekuivalent, në përputhje me natyrën e pajisjes si më sipër, pasi rezulton se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”,* pasi referuar Shtojcës 9 “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, piken B, seksioni “Profili i punonjesve” nuk është specifikuar Specialisti i siperpermendur.

Gjithashtu, ne SPE, operatori ekonomik ka ngarkuar një dokument me emertimin “certifikate” ne gjuhen angleze, por nuk është shoqeruar me perkthim nga nje perkthyes te licensuar, njehsim me orgjinalin nga Noteri dhe me Vertetim Perkthimi nga Noteri kjo ne shkelje me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: *“Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njëzuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.”*

Si edhe ne shkelje te plote me nenin 135 “Vërtetimi i përkthimeve” të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku citohet se: *“Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin*

e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.”.

Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: *“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.”*

- Operatori ekonomik **“GeoTech”shpk me NIPT K91923003D**, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim piken 3, ne te cilin percaktohet: *“Për artikullin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi, ku të evidentohen pajisjet e ofruara dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.”*, pasi konstatohet se dokumenti i ngarkuar ne SPE nuk eshte i perkthyer ne gjuhen e procedures e cila eshte gjuha (Shqipe) pasi procedura ne fjale eshte nen kufirin e ulet monetar.
- Operatori ekonomik **“GeoTech”shpk me NIPT K91923003D**, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim piken 2, ne te cilin percaktohet: *“Për artikullin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë: autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se, do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”*

KVO ka konstatuar se dokumenti i ngarkuar ne SPE nuk eshte i perkthyer ne gjuhen e procedures e cila eshte gjuha (Shqipe) pasi procedura ne fjale eshte nen kufirin e ulet monetar.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik **“ALB-MATRIX GROUP” SHPK** me nipt L91616027G dhe adresë Tirane Rruga "Isa Boletini" Shk.9 /1/A3 / Privat se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4,176,010 (katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dhjetë) Lekë pa TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor përfitues, Agjencisë Për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural me adresë: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t’iu njoftohet nga autoriteti kontraktor përfitues.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO X JO ☐

Nëse Po (*Nr.1830/2025 Datë 10.12.2025 i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR